

VENDIM
Nr. 671, datë 10.11.2021

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDË PROGRAMEVE BUXHETORE
TË VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021 bëhet rishpërndarja e fondeve brenda programeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Brendshme, si më poshtë vijon:

a) për programin “Garda e Republikës”, në zërin “Shpenzime korrente”, të shtohet fondi 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekë, për plotësimin e nevojave për shpenzime personeli dhe shpenzime të tjera, për shkak të ndryshimeve të strukturave të Gardës në numrin e personelit, numrin e mjeteve dhe personaliteteve për t’u marrë në ruajtje, si organet e vlerësimit kalimtar, SPAK-u dhe BKH-ja;

b) fondi prej 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekësh të përballohet nga pakësimi i buxhetit për programin “Gjendja Civile”, në zërin “Shpenzime korrente”, në shumën 21 00 000 (njëzet e një milionë) lekë, dhe në programin “Prefektura”, në zërin “Shpenzime korrente”, në shumën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama